



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 93, datë 06.09.2022

PËR
MIRATIMIN PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË
SHTETIT PËR EMERGJENCAT CIVILE, QË I ËSHTË ALOKUAR BASHKISË
DURRËS PËR VITIN 2022 NË VLERËN 51984331,06 LEKË

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” dhe në zbatim të shkresës së Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.1007/1, datë 17.6.2022, protokolluar në Bashki me Nr. 5566 prot, datë 21.06.2022, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e MZSH, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022 në vlerën 51984331,06 (pesdhjetë e një milion

e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e një lekë e zero gjashtë qindarka) lekë, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Njësia zbatuese	Program buxhetor	Emërtimi i projektit	Vlera në lekë
1	Bashkia Durrës	03280	Blerje mjete zjarrfikëse	46800000
2	Bashkia Durrës	03280	Hartimi i planeve të gadishmerisë së emergjencave për digat: Rada 1, Rada 2, Tarini, Boznaxhie, Rromanat, Memaj, Shkallnur, Maskuri e Vogël	480000
3	Bashkia Durrës	03280	Hartimi i pashaportave, si dhe i projektpreventivave për rehabilitimin pjesor të digave: Rada 1, Rada 2, Tarini, Boznaxhie, Rromanat, Memaj, Shkallnur, Maskuri e Vogël.	4704331,06
			TOTALI	51984331,06

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e MZSH.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Zamira Mustafaraj



U shpall sot me datë 07.09.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 700/prot.
4

Durrës, më 15 09 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.93 datë 06.09.2022

Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022 në vlerën 51984331,06 lekë.

E gjej atë të pabazuar në VKM Nr 414 dt 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”. Në përcaktimet e pikës 3.1 shkronja dh) dhe shkronja e) të kësaj VKM-je nuk parashikohet që bashkitë mund të përdorin fondin e kushtëzuar për mbrojtjen civile për blerje automjesh.

Bazuar në Ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, VKM Nr 414 dt 08.07.2021 si dhe shkresën nr 10007/12 prot dt 13.09.2022 të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile(bashkëmgjitur) nuk e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI





3
PREFEKTURA E QARKUT Durrës
HYRJE DT 700/ 15.09.22
DALJE DT 17.
Emri: Emergjini W.D.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1007/12 Prot.

Tiranë, më 13.9.2022

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr.700/6, datë 12.09.2022.

PREFEKTIT TË QARKUT Durrës
Sheshi "Liria"

Durrës

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 700/6, datë 12.09.2022, protokoll AKMC nr. 1007/11, datë 13.09.2022, "Në lidhje me përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile për vitin 2022 që i alokohet Bashkisë Durrës" Ju bëjmë me dije sa më poshtë.

Vendimi nr. 414, datë 08.07.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" parashikon që bashkitë përfitojnë nga buxheti i shtetit një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile të destinuar për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë në territorin administrativ në varësinë e tyre.

Në pikën 3.1, shkronja dh) dhe shkronja e), të VKM nr. 414, datë 08.07.2021, përcaktohet se ky fond mund të përdoret për «dh) mbajtjen në gatishmëri të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhjen e administrimit e rezervave ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë; e) mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre;»

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile gjykon se përcaktimet e shkronjës dh) dhe të shkronjës e) të VKM nr. 414, datë 08.07.2021, janë shteruese dhe nuk parashikojnë që bashkitë mund të përdorin fondin e kushtëzuar për mbrojtjen civile për blerje automjesh.

Institucionet e interesuara për interpretimin e pikës 3 të VKM nr. 414, datë 08.07.2021, nëse e gjykojnë të arsyeshme, mund t'i drejtojnë një kërkesë për interpretim strukturave përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

